

Mbeshtetur ne nenin 28 paragrafi 3 te Ligjit Nr 9723/2007 per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:

AKTIN E

THEMELIMIT

DHE

STATUTIN

E

“KUNGUL” SHPK



KAPITULLI I

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

1.1 Shoqeria "KUNGUL" (ne vijim "Shoqeria) e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk, cili perfaqeson formen ligjore te saj, si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, eshte themeluar ne date 01/12/2023.

1.2 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:

- (i) fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
- (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
- (iii) adresa e regjistruar ,dhe
- (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqerise

2.1 Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji i shoqerive"), i ndryshuar.

Neni 3. Selia shoqerise

3.1. Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen "Rruga Naim Frasheri", nr. 15, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe / ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.



Nenin 4. Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i Shoqerise

5.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, objekt i aktivitetit te Shoqerise eshte:

- Veprimtari ne fushen e mireqenies, te kujdesit trupor e mendor.

5.2 Pavec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm. Per arritjen e qellimit te mesiperm, Shoqeria mund te kryeje cdo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqerise.

Neni 6. Ndryshime

6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar; Kuotat

Article 7. Kapitali

7.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10.000 Leke (dhjete mije leke), i ndare ne 2 kuota.

Neni 8. Ortaket dhe Kuotat

8.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, kapitali i Shoqerise eshte i zoteruar nga Ortaket si me poshte:

- Znj. Erblina Shehu, e bija e Njazi dhe Ludmilla Shehu, lindur me 04.06.1981 ne Diber, mbajtes i kartes se identitetit nr. 038555241, me nr personal I15604062A, zoterues i nje (1) kuote, e cila perfaqeson 85 % te kapitalit te Shoqerise, ne vleren 8.500 leke.



- Znj. Nensi Ahmetbeja, e bija e Besnik dhe Mimoza Ahmetbeja, lindur me 01.05.1998 ne Tirane, mbajtes se pashaportes, nr BE0274325, me nr personal J85501069A, zoterues i nje (1) kuote, e cila perfaqeson 15 % te kapitalit te Shoqerise, ne vleren 1.500 leke.

Neni 9. Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te shoqerive.

9.2 Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para ose me ane te kontributeve ne natyre, si dhe me perfshirjen e rezervave (nese ka) ose fitimit apo kthimit te borxhit ne kapital.

9.3 Zmadhimi i kapitalit mund te behet duke emetuar kuota te reja apo duke rritur vleren nominale te kuotave ekzistuese.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1 Te gjithe vendimet e ortakeve do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve. Vendimet e pa regjistruara ne regjister do te konsiderohen te pavlefshme.

10.2 Cdo kuote i jep te drejten, ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), Ortakut qe e zoteron te nje numri votash te barabarte me pjesemarrjen/perqindjen e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise si dhe te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, kur deklarohet nga Ortaket e Shoqerise.

10.3 Ortaket do te kene akses te plote ne cdo informacion dhe te dhene qe ka lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, perfshire te drejten per te kontrolluar regjistrimet e Shoqerise dhe cdo dokument tjeter.

10.4 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri i ketyre Kuotave.



KAPITULLI IV

Asambleja e Pergjithshme

Neni 11. Kompetencat

- 2.1.1 11.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi kontrollues dhe vendimmarres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 2.1.2 11.2. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose me nje shumice prej $\frac{3}{4}$ e ortakeve pjesemarres ne mbledhje pasi te jete arritur kuorumi i kerkuar ne piken 86/1 te ligjit per shoqerite tregtare ("Shumica e Kualifikuar") ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:
- 2.1.3 (i) aprovimin e strategjise se Shoqerise, Planit te Biznesit, planeve financiare dhe buxhetit;
- 2.1.4 (ii) aprovimin e cdo ndryshimi ne vijim ne Planin e Biznesit te Shoqerise dhe ne planet financiare.
- 2.1.5 (iii) shperndarjen e fitimeve;
- 2.1.6 (iv) aprovimin e kontratave te Shoqerise nese nuk merret pelqimi unanim i te gjitha ortakeve te Shoqerise;
- (v) pezullimin e aktivitetit te Shoqerise dhe/ose perfundimin, shperberjen apo likuidimin e Shoqerise;
- (vi) ndryshimet, amendimet apo zevendesimet ne aktin e themelimit dhe statutin e Shoqerise;
- (vii) ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
- (viii) prezantimin e cdo kerkese per likuidim apo falimentim;
- (ix) krijimin e filialeve;
- (x) strukturen e brendshme dhe organizimin e Shoqerise;
- (xi) bashkimin me shoqeri te tjera, apo ndarjen dhe shkeputjen e Shoqerise;
- (xii) vleresimin e kontributeve ne natyre, ne mungese te eksperteve vleresues te emeruar, sipas Nenit 68/6 te Ligjit te Shoqerive;
- (xiii) zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- 11.3. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te vendose me shumice te thjeshte votash dmth 51% ne lidhje me te gjitha ceshtjet e tjera te Shoqerise qe jane te specifikuar ne nenin 81 te Ligjit per Shoqerite, te listuara si me poshte:
- 2.1.7 (i) emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuidatoreve;
- 2.1.8 (ii) percaktimi i shperblimit te auditoreve dhe likuidatoreve;

- 2.1.9 (iii) mbikqyrjen dhe monitorimin e veprimtarise se Administratoreve ne zbatimin e politikave tregtare, pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 2.1.10 (iv) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 2.1.11 (v) perfaqesimin e Shoqerise perpara Gjykates si dhe ne ceshtjet gjyqesore kunder Administratoreve; dhe 2.1.12 (vi) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- 2.1.13 (vii) Ceshtje te tjera te cilat do te parashikohen nga Ortaket.

Neni 12. Thirrja e Asamblese se pergjithshme

- 2.1.15 12.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.
- 2.1.16 12.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 2.1.17 12.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter, asetete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitheteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 2.1.18 12.4 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje asetete qe i perkasin nje ortaku te Shoqerise, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 2.1.19 12.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja e Pergjithshme do te vendose ne baze te nje raporti nga nje ekspert kontabel i autorizuar, qe dorezohet tek kjo Asamble, pervec rasti kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 2.1.20** 12.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret cdo tre muaj me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratoret gjate atij tre mujori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e Ortakeve, perfshire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord ne menyre unanime.
- 2.1.21**
- 2.1.22 12.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.



Neni 13. Menyra e Thirrjes

- 2.1.23 13.1. Asambleja e Pergjithshme vendos per ceshtjet e paraqitura ne nenet e mesiperme 11 dhe 12, nepermjet thirrjes se mbledhjeve.
- 2.1.24 13.2. Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.
- 2.1.25 13.3. Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranes, Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste elektronike apo njoftim me shkrim te pakten 7 dite para mbledhjes. Persa i perket vendimeve qe merren jashte Republikes se Shqiperise, Administratorit(eve) u vihet ne dispozicion nje kopje e shkruar e ketyre vendimeve te cilen Administratori(et) e ruajne ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise, qe mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratoreve. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjitha Ortaket bien dakort.
- 2.1.26 13.4. Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
- 2.1.27** 13.5. Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Vendimi i propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me mjete te sigurta elektronike. Ortaku(et) do te marrin vendim per vendimin perkates brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar vendimi. Ortaku(et) miratojne vendimin duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te vendimit me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me vendimin shprehin me shkrim kundershite e tyre ne lidhje me vendimin dhe i'a kthejne ate Administratorit(eve) te Shoqerise. Vendimi me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar ne perputhje me Seksionin 11, me siper.
- 2.1.28 13.6. Cdo kuote perfaqeson nje numer votash te barabarte me pjesemarrjen ne kapital te Ortakut qe zoteron ate.
- 2.1.29 13.7. Vendimet e Ortakeve te marra ne perputhje me kete statut si dhe me Ligjin per Shoqerite do te jene te detyrueshme per Shoqerine. Cdo vendim i tille mund te merret gjithashtu jashte territorit te Republikes se Shqiperise, dhe evidence me shkrim e ketij vendimi do t'i dorezohet Administratorit(ve) qe do ta regjistroje ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise.
- 2.1.30 13.8. Atehere kur ligji e kerkon kete, vendimet e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto vendime miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).
- 2.1.31 13.9. Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.
- 2.1.32 13.10. Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

2.1.33 Neni 14. Perjashtimi nga e drejta e votes

14.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku;
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria;
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

14.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar me prokure nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder ortaku te cilin perfaqeson.

KAPITULLI V

Neni 15. Administratoret

15.1. Shoqeria mund te drejtohet nga nje ose disa Administratore. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

15.2.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Shoqeria drejtohet nga 1 administrator:

- - Znj. Erblina Shehu, e bija e Njazi dhe Ludmilla Shehu, lindur me 4 Qershor 1981 ne Diber, mbajtes i kartes se identitetit me nr.038555241, e nr personal I15604062A.

15.3 Kohezgatja e emerimit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti qe ky statut nenshkruhet, me te drejte ripertesitje te ketij mandati.

15.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratoret njohin se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; ne kete drejtim vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

15.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Administratorin/et me shumice te thjeshte votash.

15.6 Nese Administrator/et e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, ceshtja do te referohet tek Ortaket te cilet vendosin ne perputhje me Seksionin 12, ne varesi te ceshtjes qe do te shqyrtohet.

15.7 Secili prej administratoreve ka te drejte te perfaqesoje Shoqerine si dhe te ushtroje kompetencat e tij ligjore me vete, pa qene e nevojshme prezenca apo firma e administratorit tjetet.

Neni 16. Kompetencat dhe detyrimet

16.1. Kompetencat e Administratoreve ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 12;
- (ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme;
- (iii) Perfaqesimin e Shoqerise;
- (iv) Te sigurohen per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, kur eshte e nevojshme;

- (vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e transakcioneve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise; (viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

16.2.1 Administratoret mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratoret duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

Neni 17. Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

17.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administrator/et detyrohen:

- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi;
- (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave te tyre personale me ato te Shoqerise;
- (v) te garantoje miratimin e dhene per marreveshjet e pershkruara ne dispozitat e pikes 3 te nenit 13 te Ligjit te shoqerive; (vi) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

17.2. Administratoret mbajne pergjegjesi per cdo veprim apo mungese veprimi, me perjashtim te rasteve kur veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacionit te lidhur ne menyre te drejteperdrejte me qellimet e Shoqerise.

17.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 17.1 dhe 17.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata jane pergjegjes ndaj Shoqerise ne menyre solidare dhe vecmas.

17.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:



- (i) ju rishperndan Ortakeve kontributet;
- (ii) ju paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- (iii) shperndan asetet e Shoqerise;
- (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;

KAPITULLI VI

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 18. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 18.1. Ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KAPITULLI VII

Aktiviteti I Shoqerise

Neni 19. Viti ekonomiko-financiar

- 19.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit.

Neni 20. Mbajtja e Llogarive

- 20.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne Leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 21. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

- 21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me kete Statut, dhe me ligjet e zbatueshme.

- 3 21.2 Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

- 21.3 Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit, dhe
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.

- 21.4 Administratoret leshojne nje "certifikate te aftesise paguese", e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar permbush kerkesat e pikes 21.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar nuk i permbush keto kriteret, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

- 21.5 Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KAPITULLI VIII
Ndryshimi i Formes Ligjore; Prishja

Neni 22. Ndryshimi i Formes Ligjore

- 22.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 11 te Statutit dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 22.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 23 Prishja e Shoqerise

- 23.1. Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:
- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
 - (ii) Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
 - (iii) Me hapjen e procedurave te likujdimit/falimentimit;
 - (iv) Me vendim te Gjykates;
 - (v) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.
- 23.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia dergon vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KAPITULLI IX

Te ndryshme

Neni 24. Largimi i Ortakut

- 24.1. Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 25. Te tjera

- 25.1 Cdo ceshtje tjetere, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

* * * * *

01/12/2023

ORTAKU

Erdina Shehu


ORTAKU

Nensi Ahmetbeja
